

LIGJ
Nr. 20/2022

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
PËR ORGANIZATËN HIDROGRAFIKE NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.2.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13511, datë 16.3.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

KONVENTA PËR ORGANIZATËN HIDROGRAFIKE NDËRKOMBËTARE,
E NDRYSHUAR ME PROTOKOLLIN E NDRYSHIMEVE TË KONVENTËS PËR
ORGANIZATËN HIDROGRAFIKE NDËRKOMBËTARE,
TË HYRË NË FUQI MË 8 NËNTOR 2016

PËRMBAJTJA

NENI	OBJEKTI
	PREAMBULË
I	Themelimi dhe selia
II	Natyra dhe fusha e zbatimit
III	Anëtarët
IV	Organet
V	Asambleja
VI	Këshilli
VII	Komiteti i Financave
VIII	Sekretariati
IX	Votimi
X	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare
XI	Funksionimi i Organizatës, i përkufizuar në rregulloret e përgjithshme dhe financiare
XII	Gjuhët zyrtare
XIII	Personaliteti Juridik – Statusi Ndërkombëtar
XIV	Fondet
XV	Shumat e prapambetura në kontribute
XVI	Depozituesi

XVII	Mosmarrëveshjet
XVIII	Nënshkrimi
XIX	Hyrja në fuqi
XX	Aderimi
XXI	Ndryshimet
XXII	Denoncimi
XXIII	Regjistrimi në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara
Aneksi	Certifikatë Regjistrimi të Sekretariati i OKB-së

KONVENTË PËR ORGANIZATËN HIDROGRAFIKE NDËRKOMBËTARE

Shtetet palë të kësaj Konvente,
duke pasur parasysh se Byroja Ndërkombëtare Hidrografike është themeluar në qershor të vitit 1921, për të kontribuar në kryerjen më të lehtë dhe të sigurt të lundrimit në të gjithë botën, duke përmirësuar hartat dhe dokumentet detare;

duke pasur parasysh se Organizata Ndërkombëtare Hidrografike është një organizatë ndërkombëtare kompetente që, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të së Drejtës së Detit, koordinon në shkallë botërore caktimin e standardeve, për prodhimin e të dhënave hidrografike dhe ofrimin e shërbimeve hidrografike, dhe që lehtëson ndërtimin e kapaciteteve në shërbimet hidrografike të brendshme;

duke pasur parasysh se vizioni i Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare është që të jetë organi hidrografik autoritar në të gjithë botën që angazhon aktivisht të gjitha shtetet bregdetare dhe të interesuar për të rritur sigurinë dhe eficiencën detare, dhe që mbështet mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit detar;

duke pasur parasysh se misioni i Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare është krijimi i një mjedisi global në të cilin shtetet japin të dhëna, produkte dhe shërbime hidrografike të përshtatshme dhe në kohë, dhe garantojnë përdorimin më të gjerë të mundshëm; dhe

me dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin me bazë ndërqeveritare në hidrografi,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni I

Themelohet Organizata Hidrografike Ndërkombëtare, që në vijim referohet si Organizata, selia e së cilës ndodhet në Monako.

Neni II

Organizata ka një natyrë konsultative dhe teknike. Fusha e aktivitetit të Organizatës është:

- a) nxitja e përdorimit të hidrografisë për sigurinë e lundrimit dhe të gjitha qëllimet e tjera detare, dhe forcimi i ndërgjegjësimit global për rëndësinë e hidrografisë;
- b) përmirësimi i mbulimit global, disponibilitetit dhe cilësisë së të dhënave hidrografike, informacionit, produkteve dhe shërbimeve, si dhe lehtësimi i aksesit të këto të dhëna, informacione, produkte dhe shërbime;
- c) përmirësimi i aftësisë, kapacitetit, trajnimit, shkencës dhe teknikës hidrografike globale;
- d) ngritja dhe fuqizimi i zhvillimit të standardeve ndërkombëtare për të dhënat hidrografike, informacionin, produktet, shërbimet dhe teknikat, dhe arritja e njëtrajtshmërisë më të madhe të mundshme në përdorimin e këtyre standardeve;
- e) dhënia e udhëzimeve të sigurta dhe në kohë për të gjitha çështjet hidrografike për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare;
- f) lehtësimi i bashkërendimit të aktiviteteve hidrografike ndërmjet shteteve anëtare; dhe
- g) rritja e bashkëpunimit mbi aktivitetet hidrografike ndërmjet shteteve mbi bazë rajonale.

Neni III

Shtetet anëtare të Organizatës janë shtetet palë të Konventës.

Neni IV

Organizata përbëhet nga:

- a) Asambleja;
- b) Këshilli;
- c) Komiteti i Financave;
- d) Sekretariati; dhe
- e) çdo organ varësie.

Neni V

a) Asambleja është organi kryesor dhe ka të gjitha kompetencat e Organizatës, përveç kur parashikohet ndryshe në Konventë ose i delegohet nga Asambleja organeve të tjera;

b) Asambleja përbëhet nga të gjitha shtetet anëtare;

c) Asambleja mblidhet në seanca të zakonshme çdo tre vjet. Seancat e jashtëzakonshme të Asamblesë mund të mbahen me kërkesë të një shteti anëtar ose të Këshillit ose të Sekretarit të Përgjithshëm, me miratimin e shumicës së shteteve anëtare;

d) Një shumicë e shteteve anëtare përbën një numër të mjaftueshëm për mbledhjet e Asamblesë;

e) Funksionet e Asamblesë janë:

i. zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit;

ii. përcaktimi i rregullave të veta procedurale dhe atyre të Këshillit, Komitetit të Financave dhe çdo organi varësie të Organizatës;

iii. në pajtim me rregulloret e përgjithshme, zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorëve, dhe përcaktimi i termave dhe kushteve për shërbimin e tyre;

iv. ngritja e organeve të varësisë;

v. përcaktimi i politikës së përgjithshme, strategjisë dhe programit të punës së Organizatës;

vi. shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga Këshilli;

vii. shqyrtimi i vëzhgimeve dhe rekomandimeve të paraqitura nga shtetet anëtare, Këshilli ose Sekretari i Përgjithshëm;

viii. vendimmarrja për çdo propozim të bërë nga çdo shtet anëtar, Këshilli ose Sekretari i Përgjithshëm;

ix. rishikimi i shpenzimeve, miratimi i llogarive dhe përcaktimi i masave financiare të organizatës;

x. miratimi i buxhetit trevjeçar të Organizatës;

xi. vendimmarrja mbi shërbimet operationale;

xii. vendimmarrja mbi çështje të tjera brenda sferës së veprimit të Organizatës; dhe

xiii. delegimi, sipas rastit dhe nevojës, i përgjegjësive të Këshillit.

Neni VI

a) Një e katërta, por jo më pak se tridhjetë nga shtete anëtare zënë vende në Këshill, dy të tretat e para të të cilëve i zënë vendet e tyre mbi bazë rajonale dhe një e treta tjetër mbi bazën e interesave hidrografike që përcaktohen në rregulloret e përgjithshme.

b) Parimet për përbërjen e Këshillit përcaktohen në rregulloret e përgjithshme.

c) Anëtarët e Këshillit e ushtrojnë funksionin deri në fund të seancës pasuese të zakonshme të Asamblesë.

- d) Dy të tretat e anëtarëve të Këshillit përbëjnë numrin e nevojshëm vendimmarrës.
- e) Këshilli mbledhet të paktën një herë në vit.
- f) Shtetet anëtare që nuk janë anëtarë të Këshillit, mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, por nuk kanë të drejtën e votës.
- g) Funksionet e Këshillit janë:
 - i. zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit, secili prej të cilëve e ushtron funksionin deri në fund të seancës pasuese të zakonshme të Asamblesë;
 - ii. ushtrimi i përgjegjësiqe që mund t'i delegohen nga Asambleja;
 - iii. bashkërendon, gjatë periudhës ndërmjet seancave të Asamblesë, aktivitetet e Organizatës brenda kuadrit të strategjisë, programit të punës dhe masave financiare, sipas vendimmarrjes së Asamblesë;
 - iv. raportimi në Asamble, në çdo seancë të zakonshme, mbi punën e Organizatës;
 - v. përgatitja, me mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm, e propozimeve në lidhje me strategjinë e përgjithshme dhe programin e punës që do të miratohet nga Asambleja;
 - vi. shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe parashikimeve buxhetore të përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm dhe paraqitja e tyre për miratim në Asamble, me komente dhe rekomandime, në lidhje me alokimet programatike të parashikimeve buxhetore;
 - vii. rishikimi i propozimeve të paraqitura nga organet e varësisë dhe referimi i tyre:
 - Asamblesë, për të gjitha çështjet që kërkojnë vendimmarrje nga Asambleja;
 - Përsëri tek organi i varësisë, nëse kjo çmohet e nevojshme; ose
 - Shteteve anëtare për miratim, nëpërmjet korrespondencës;
 - viii. propozimi në Asamble i ngritjes së organeve të varësisë; dhe
 - ix. rishikimi i projekt marrëveshjeve ndërmjet Organizatës dhe organizatave të tjera, dhe paraqitja e tyre Asamblesë për miratim.

Neni VII

- a) Komiteti i Financave është i hapur për të gjitha shtetet anëtare. Çdo shtet anëtar ka një votë.
- b) Komiteti i Financave normalisht mbledhet i bashkërenduar në çdo seancë të zakonshme të Asamblesë dhe mund të thërrasë mbledhje shtesë, sipas rastit.
- c) Funksionet e Komitetit të Financave janë rishikimi i pasqyrave financiare, parashikimeve buxhetore dhe raportimeve mbi çështjet administrative të përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe paraqitja e vëzhgimeve dhe rekomandimeve të tij mbi to, Asamblesë.
- d) Komiteti i Financave zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

Neni VIII

- a) Sekretariati përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, drejtorët dhe personeli tjetër sipas kërkesave të Organizatës.
- b) Sekretari i Përgjithshëm mban të gjitha regjistrat që mund të jenë të nevojshme për përmbushjen efikase të aktivitetit të Organizatës dhe përgatit, mbledh dhe qarkullon çdo dokumentacion që mund të kërkohe.
- c) Sekretari i Përgjithshëm është punonjësi më i lartë administrativ i Organizatës.
- d) Sekretari i Përgjithshëm:
 - i. përgatit dhe i paraqet Komitetit të Financave dhe Këshillit pasqyrat financiare për çdo vit dhe parashikimet buxhetore me bazë tre vjetore, me parashikimet për çdo vit të specifikuar të ndara; dhe
 - ii. mban të informuar shtetet anëtare, në lidhje me aktivitetet e Organizatës.
- e) Sekretari i Përgjithshëm përmbush ato detyra të tjera që mund të caktohen nga Konventa, Asambleja ose Këshilli.

f) Në përmbushje të detyrave të tyre, Sekretari i Përgjithshëm, drejtorët dhe personeli nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë shtet anëtar apo nga ndonjë autoritet jashtë Organizatës. Ata nuk kryejnë asnjë veprim që mund të jetë i papajtueshëm me pozicionet e tyre si punonjës ndërkombëtarë. Çdo shtet anëtar, nga ana e vet, merr përsipër të respektojë karakterin ekskluziv ndërkombëtar të përgjegjësive të Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorëve dhe personelit, dhe nuk synon të ndikojë tek ta në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

Neni IX

Nëse vendimet nuk mund të arrihen me konsensus, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, secili shtet anëtar ka një votë;

b) për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorëve, secili shtet anëtar ka një numër votash të përcaktuar nga një shkallëzim i vendosur sipas tonazhit të flotave të tyre;

c) përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, vendimet merren nga një shumicë e thjeshtë e shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë, dhe nëse votat janë të barabarta, vendos kryetari;

d) vendimet e marra për çështje që lidhen me politikën ose financat e Organizatës, përfshirë ndryshimet në rregulloren e përgjithshme dhe financiare, merren nga shumica me dy të tretat e shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë;

e) në lidhje me nënparagrafët “c” dhe “d”, të këtij neni dhe nënparagrafin “b”, të nenit XXI më poshtë, fraza “Shtetet anëtare të pranishme dhe që votojnë” nënkupton shtetet anëtare të pranishme dhe që japin një votë në favor ose kundër. Shtetet anëtare që abstenojnë nga votimi konsiderohen sikur nuk votojnë;

f) në rastin e një prezantimi në shtetet anëtare në pajtim me nenin VI g/vii, vendimi merret nga shumica e shteteve anëtare që hedhin një votë, kur numri minimal i votave në favor është të paktën një e treta e të gjitha shteteve anëtare.

Neni X

Në lidhje me çështjet brenda sferës së saj të aktivitetit, Organizata mund të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare, interesat dhe aktivitetet e të cilave lidhen me qëllimin e Organizatës.

Neni XI

Funksionimi i Organizatës përcaktohet hollësisht në rregulloret e përgjithshme dhe financiare, të cilat i bashkëlidhen kësaj Konvente por nuk përbëjnë pjesë integrale të saj. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis kësaj Konvente dhe rregullave të përgjithshme ose financiare, Konventa do të ketë përparësi.

Neni XII

Gjuhët zyrtare të Organizatës janë gjuha angleze dhe frënge.

Neni XIII

Organizata ka personalitet juridik. Në territorin e secilit prej shteteve anëtare të saj, ajo gëzon, në përputhje me marrëveshjen me shtetin anëtar të interesuar, ato privilegje dhe imunitete që mund të jenë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e objektivit të saj.

Neni XIV

Shpenzimet e nevojshme për funksionimin e Organizatës mbulohen:

- a) nga kontributet e zakonshme vjetore të shteteve anëtare, në përputhje me një shkallëzim të bazuar në tonazhin e flotave të tyre; dhe
- b) nga donacionet, trashëgimitë, subvencionet dhe burime të tjera, me miratimin e Asamblesë.

Neni XV

Çdo shteti anëtar i cili ka dy vjet vonesë në kontributet e tij, i refuzohen të gjitha të drejtat e votës dhe përfitimet që u jepen shteteve anëtare nga Konventa dhe rregulloret derisa të jenë shlyer kontributet e papaguara.

Neni XVI

- a) Qeveria e Madhërisë së Tij, Princit të Monakos, shërben si Depozitues.
 - b) Ky origjinal i Konventës mbahet nga Depozituesi, i cili u transmeton kopje të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha shteteve që e kanë nënshkruar ose aderuar në të.
 - c) Depozituesi:
 - Informon Sekretarin e Përgjithshëm dhe të gjitha shtetet anëtare mbi kërkesat për aderim të marra prej tij nga shtetet e referuara në nenin XX/b; dhe
 - Informon Sekretarin e Përgjithshëm dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë aderuar në të, për:
 - çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;
 - datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe çdo ndryshimi të saj; dhe
 - depozitimin e çdo instrumenti denoncimi të Konventës, së bashku me datën kur është marrë dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.
- Sapo një ndryshim i kësaj Konvente hyn në fuqi, ai publikohet nga Depozituesi dhe regjistrohet në Sekretarinë e Kombeve të Bashkuara, në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni XVII

Çdo mosmarrëveshje, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk zgjidhet me negociata ose nga zyrat e ndërmjetësimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës, me kërkesë të njëres prej palëve të mosmarrëveshjes, i referohet një arbitri të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Neni XVIII¹

1. Kjo Konventë është e hapur në Monako, më 3 maj 1967, dhe më pas në Legatën e Principatës së Monakos në Paris, nga 1 qershori deri më 31 dhjetor 1967, për nënshkrim nga çdo qeveri që merr pjesë në aktivitetin e Byrosë më 3 maj 1967.
2. Qeveritë e përmendura në paragrafin 1 më sipër mund të bëhen palë të kësaj Konvente:
 - a) me nënshkrim pa rezerva për ratifikim ose miratim; ose
 - b) me nënshkrim që i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit dhe depozitimit pasues të një instrumenti ratifikimi ose miratimi.
3. Instrumentet e ratifikimit ose miratimit i dorëzohen Legatës së Principatës së Monakos në Paris për t'u depozituar në Arkivat e Qeverisë së Principatës së Monakos.

¹ Dispozitë historike

4. Qeveria e Principatës së Monakos informon qeveritë e përmendura në paragrafin 1 më lart dhe Presidentin e Komitetit Drejtues për çdo nënshkrim dhe depozitim të një instrumenti ratifikimi ose miratimi.

Neni XIX²

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën njëzet e tetë qeveri janë bërë palë, në pajtim me dispozitat e nenit XVIII, paragrafi 2.

2. Qeveria e Principatës së Monakos ua njofton këtë datë të gjitha qeverive nënshkruese dhe Presidentit të Komitetit Drejtues.

Neni XX

a) Kjo Konventë mbetet e hapur për aderim nga çdo shtet që është anëtar i Kombeve të Bashkuara. Konventa hyn në fuqi për një shtet të tillë në datën kur ai depoziton instrumentin e tij të aderimit pranë Depozituesit, i cili informon Sekretarin e Përgjithshëm dhe të gjitha shtetet anëtare.

b) Një shtet që nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara, mund të aderojë në këtë Konventë vetëm duke bërë kërkesë te Depozituesi dhe pasi t'i miratohet kërkesa e tij nga dy të tretat e shteteve anëtare. Konventa hyn në fuqi për një shtet të tillë në datën kur ai depoziton instrumentin e tij të aderimit pranë Depozituesit, i cili informon Sekretarin e Përgjithshëm dhe të gjitha shtetet anëtare.

Neni XXI

a) Çdo shtet anëtar mund të propozojë ndryshime në këtë Konventë. Propozimet e ndryshimeve i transmetohen Sekretarit të Përgjithshëm, jo më pak se gjashtë muaj para seancës së ardhshme të Asamblesë.

b) Propozimet e ndryshimeve shqyrtohen nga Asambleja dhe vendosen me shumicën e dy të tretave të shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë. Nëse një ndryshim i propozuar miratohet nga Asambleja, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës i kërkon Depozituesit t'ua paraqesë atë të gjitha shteteve anëtare.

c) Ndryshimi hyn në fuqi për të gjitha shtetet anëtare tre muaj pasi njoftimet e pëlqimit për t'u nënshtruar asaj nga dy të tretat e shteteve anëtare, merren nga Depozituesi.

Neni XXII

Pas skadimit të një periudhe prej pesë vjetësh pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë mund të denoncohet nga çdo palë kontraktuese, duke bërë njoftim paraprak me afat të paktën një vit, në një njoftim drejtuar Depozituesit. Denoncimi hyn në fuqi në datën 1 janar që pason skadimin e njoftimit dhe përfshin heqjen dorë nga shteti në fjalë nga të gjitha të drejtat dhe përfitimet e anëtarësimit në Organizatë.

Neni XXIII³

Pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë regjistrohet nga Qeveria e Principatës së Monakos në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara, në pajtim me nenin 102 të Kartës së saj.

² Dispozitë historike.

³ Dispozitë historike.

Shënim. Shihni aneksin A.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Monako, në ditën e tretë të majit, një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku secili tekst është njëloj autentik që do të depozitohet në Arkivat e Qeverisë së Principatës së Monakos, e cila u transmeton kopje të vërtetuara të gjithë nënshkruesve dhe qeverive aderuese dhe Presidentit të Komitetit Drejtues.

Shtojca A e Konventës OHN

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË KONVENTËS SË OHN-së DHE TË RREGULLOREVE TË PËRGJITHSHME NË SEKRETARIATIN E OKB-së

CERTIFIKATË REGJISTRIMI NR. 16427

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Vërteton se Qeveria e Principatës së Monakos ka regjistruar në Sekretariat, në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare (me rregulloret e përgjithshme).

Nënshkruar në Monako, më 3 maj 1967.

Regjistrimi u krye më 22 shtator 1970, me nr. 10764.

Bërë në Nju Jork, më 25 janar 1971.

Për Qeverinë e

Principatës së Monakos

Për Sekretarin e Përgjithshëm

(Nënshkrimi)

Neni 102 i Kartës së Kombeve të Bashkuara

1. Çdo traktat dhe çdo marrëveshje ndërkombëtare e lidhur nga një Anëtar i Kombeve të Bashkuara, pas hyrjes në fuqi të kësaj Karte, regjistrohet sa më shpejt që të jetë e mundur në Sekretariat dhe publikohet prej tij.

2. Asnjë palë e ndonjë traktati të tillë ose marrëveshjeje ndërkombëtare, e cila nuk është regjistruar në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund t'i referohet traktatit ose marrëveshjes para ndonjë organi të Kombeve të Bashkuara.

QEVERIA E ...

INSTRUMENTI I ADERIMIT

PËR NË KONVENTËN E ORGANIZATËS HIDROGRAFIKE NDËRKOMBËTARE

Unë, Ministri i Punëve të Jashtme të, deklaroj këtu se:

Qeveria e, në bazë të këtij dokumenti aktual, aderon në “Konventën mbi Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare”, e bërë në Monako, më 3 maj 1967, dhe e amenduar nga Protokolli i datës 14 prill 2005, që ka hyrë në fuqi më 8 nëntor 2016.

Në dëshmi të kësaj, unë kam nënshkruar këtë Instrument Aderimi dhe kam vendosur këtu vulën e qeverisë së

Bërë në, këtë ditë XX të marsit 2019.

Ministri i Punëve të Jashtme të qeverisë së

SHEMBULL I NJË NOTE VERBALE, PËR NJË SHTET ANËTAR TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR TË APLIKUAR PËR ANËTARËSIM NË IHO

[Ministri i Punëve të Jashtme/zyrtari përkatës i autorizuar i qeverisë] i [] i paraqet komplementet e tij ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit të Principatës së Monakos dhe ka nderin të deklarojë se qeveria e [] dëshiron të bëhet një shtet anëtar i Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare.

Në mbështetje të dëshirës së tij, [ministri i Punëve të Jashtme/zyrtari përkatës i Autorizuar i Qeverisë] ka nderin të pohojë se qeveria e [] paraqet në Konventën mbi Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare një kopje të instrumentit të aneksuar këtu.

Për më tepër, [ministri i Punëve të Jashtme/zyrtari përkatës i autorizuar i qeverisë] i [] ka nderin të deklarojë se tonazhi bruto i flotës tregtare dhe anijeve të luftës të [], llogaritur në përputhje me nenin 5, të Rregullave Financiare të Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare, është [..... ..] tonë.

[Ministri i Punëve të Jashtme/zyrtari përkatës i autorizuar i qeverisë] i [] do të ishte mirënjohës nëse ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit të Principatës së Monakos do të konfirmonte pranimin e [] si një shtet anëtar i Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare dhe do të informonte shtetet anëtare dhe Sekretariatin e Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare, përkatësisht.

[Ministri i Punëve të Jashtme/zyrtari përkatës i autorizuar i qeverisë] së [] falënderon ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Bashkëpunimit të Principatës së Monakos, dhe shfrytëzon këtë mundësi për t'i përcjellë [atij/asaj] sigurinë e konsideratave të [tij/saj] më të larta.